# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-398622**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kuçovë/ Shoqëruan me forcë një person, Hita pezullon nga detyra 3 efektivët e policisë – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/kucove-shoqeruan-me-force-nje-person-hita-pezullon-nga-detyra-3-efektivet-e-policise/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 6 shtator 2026, 00:17:44 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 3 shtator 2026, 15:07:11 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `5a2c7b50239c8415a5d5887db28995705268c63f3d4a837bdd07d5e0dad727c3` |
| TEKSTI | `8a8b4d821a9d22e75a03215743025d3434771ac6fb997a866e9bbce08b91d999` |
| PAMJA | `9f25afebfbde6f6536d73587abbdf6236c8c46dd94311157fb3e5d579ccd7f0c` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `89de513e1122f2560c8455e842e8f9bbb7e12f82ea06695bd9010758b318196b` |
| E MËPARSHMJA | `c941dcd68c68167e1d9cb536ad1ef252d27f730e9cc17624971bcb71c041ae84` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/89de513e1122f2560c8455e842e8f9bbb7e12f82ea06695bd9010758b318196b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

5 Viti i ri shkollor nis edhe në burgun e Korçës, 31 të dënuar ndjekin...

Hetimi disiplinor do të fokusohet te dyshimet për “përdorim të paligjshëm dhe të paarsyeshëm të forcës” dhe “kryerje të veprimeve që cenojnë rëndë figurën e punonjësit të Policisë, institucionin apo shërbimin policor në tërësi”.

Policia sqaron se shoqërimi i shtetasit D.T. nuk lidhej me punime ndërtimi pa leje, por me një kallëzim të bërë ndaj tij për kanosjen e kunatës së tij, V. T.

Sipas Policisë, më 20 korrik 2026, V. T. është paraqitur në Komisariatin e Kuçovës dhe ka kallëzuar se ishte kanosur nga D.T., ndërsa më 3 gusht shërbimet e Policisë kanë shkuar në fshatin Krekëz pasi ai nuk kishte pranuar të paraqitej vullnetarisht për t’u pyetur.

**Reagim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit:**

Në lidhje me një video të publikuar në rrjete sociale, ku shfaqet shoqërimi i një shtetasi nga punonjësit e Policisë së Komisariatit të Policisë Kuçovë, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Drejtues Madhor Skender Hita ka pezulluar menjëherë nga detyra 3 punonjësit e Komisariatit të Policisë Kuçovë që shfaqen në video, konkretisht: inspektorët K. M. dhe D. D., oficerë të Patrullës së Përgjithshme, si dhe inspektor A. M., ndihmësspecialist (SPZ).

Gjithashtu, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, në zbatim të kërkesave të ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe të Rregullores së Policisë së Shtetit, ka urdhëruar Drejtorinë e Standardeve Profesionale, në DPPSH, për

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

Shtetit, ka urdhëruar Drejtorinë e Standardeve Profesionale, në DPPSH, për nisjen e hetimit disiplinor ndaj 3 punonjësve të pezulluar nga detyra, për shkeljet "Përdorimi i paligjshëm dhe i paarsyeshëm i forcës" dhe "Kryerja e veprimeve që cenojnë rëndë figurën e punonjësit të Policisë, institucionin apo shërbimin policor në tërësi".

Ndërkohë, sqarojmë opinionin publik se shoqërimi i shtetasit D. T., që shfaqet në video, nuk është bërë për kryerjen e punimeve të ndërtimit pa leje, por për shkak se ndaj tij është bërë kallëzim për kanosjen e kunatës së tij.

Më datë 20.07.2026, në Komisariatin e Policisë Kuçovë është paraqitur kunata e shtetasit D. T., shtetasja V. T., e cila ka kallëzuar se ky shtetas e kishte kanosur.

Në kuadër të veprimeve procedurale të kryera nga Komisariati i Policisë Kuçovë dhe pas konsultimit me Prokurorinë e Beratit, më datë 03.08.2026, shërbimet e Policisë kanë shkuar në fshatin Krekëz, për të shoqëruar shtetasin D. T., i cili nuk kishte pranuar të paraqitej vullnetarisht në Komisariat, pas njoftimit nga ana e Policisë, për t'u pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime.

Në vijim të veprimeve për rastin, materialet procedurale janë referuar në Prokurori, për veprën penale "Kanosja", parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal.

Duke qenë se palët janë në situatë konfliktuale dhe në proces gjyqësor për një pronë (tokë), Komisariati i Policisë Kuçovë e ka trajtuar në mënyrë të vazhdueshme problematikën ndërmjet tyre, me qëllim parandalimin e përshkallëzimit të situatës, duke reaguar ndaj çdo njoftimi dhe duke kryer veprimet procedurale në përputhje me ligjin.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit garanton qytetarët se çdo pretendim për shkelje të ligjit apo të standardeve profesionale nga ana e punonjësve të Policisë do të verifikohet me seriozitet dhe paanshmëri.

Çdo punonjës Policie që konstatohet se ka shkelur ligjin, rregullat e shërbimit apo ka cenuar besimin e qytetarëve me veprimet e tij, do të mbajë përgjegjësi sipas parashikimeve të ligjit dhe të Rregullores së Policisë së Shtetit.

#Dhunim #Efektivet #Kuçove #Pezullim #VizionPlus

**Redaksia Web**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.
Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



VENDI
**DETAJET/ 42 kg kokainë në mishin e...**
Xhuljana Zhuleku · 16 minuta më parë



VENDI
**Parashikimi i motit për sot, vranësira dhe...**
Xhuljana Zhuleku · 1 orë më parë



POLITIKË
**Ilir Meta del nga kafazi, kreu i PL-së d...**
Xhuljana Zhuleku · Dje 17:17




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.